



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Istog
Opština Istok
Istog Municipality

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Tel: 038/200 438 14

KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY ISTOG

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e pesëmbëdhjeta e rregullt e Legjislacionit të VII-të të Kuvendit të Komunës së Istogut, mbajtur më: **31.07.2023**, në Sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, filluar me punë në ora **10:00**.

Në mbledhje ishin të pranishëm këta këshilltarë:

- | | |
|---------------------------------------|------------------------------------|
| 1. <u>Enver Rugova, LDK;</u> | 13. <u>Nexhmedin Balaj, AAK;</u> |
| 2. <u>Hajrush Shoshi, LDK;</u> | 14. <u>Ardita Idrizaj, AAK;</u> |
| 3. <u>Faruk Kabashi, LDK;</u> | 15. <u>Ajshe Metaj, AAK;</u> |
| 4. <u>Haki Podrimaj, LDK;</u> | 16. <u>Negjdet Ramaj, AAK;</u> |
| 5. <u>Ruzhdi Metaj, LDK;</u> | 17. <u>Fjolla Ukaj, AAK;</u> |
| 6. <u>Faik Alushaj, LDK;</u> | 18. <u>Florin Dreshaj, VV;</u> |
| 7. <u>Veton Kurtaj, LDK;</u> | 19. <u>Niman Beqiraj, VV;</u> |
| 8. <u>Arta Balaj, LDK;</u> | 20. <u>Floriana Maxharraj, VV;</u> |
| 9. <u>Liridona Lajçi Avdiaj, LDK;</u> | 21. <u>Lavdiqe Bujupaj, VV;</u> |
| 10. <u>Valbona Demaj, LDK;</u> | 22. <u>Andi Xhuraj, PDK;</u> |
| 11. <u>Njomza Demaj, LDK;</u> | 23. <u>Visar Haxhijaj, PDK;</u> |
| 12. <u>Arianit Selmanaj, AAK;</u> | 24. <u>Era Visoqi, PDK;</u> |

Mbledhja ishte e hapur dhe në mbledhje ishin të pranishëm: Kryetari i Komunës z. Ilir Ferati, Nënkryetari i Komunës, z. Ali Nimanaj, nënkryetari për Komunitete z. Valmir Rama, Drejtoret e Drejtorive, përfaqësues të OSBE-së, KFORI-të, monitoruesja nga DEMOS – KDI, zyrtarë administrativ si dhe media lokale RTV – Fontana (lista e nënshkrimeve të evidencës së pjesëmarrjes është pjesë përbërëse e këtij procesverbali dhe e njëjta gjendet në dosje: "shembulli 1")

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar edhe CD^{te} e xhirimit gjenden në dosje: "shembulli 2").

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar dhe publikuar drejtpërdrejt në youtube: : "shembulli 3").

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Enver Rugova.

Procesverbali

Kryesuesi i Kuvendit, z. Enver Rugova – përshëndeti të gjithë të pranishmit në këtë mbledhje.

Hap punimet për mbledhjen e njëmbëdhjetë të rregullt të Legjislacionit të VII-të dhe për këtë mbledhje propozoi këtë rend dite:

Konstaton Kuorumin për mbajtjen e mbledhjes në bazë të listës së nënshkrimeve dhe prezencës tuaj këtu prezent janë 26 të anëtarë të Kuvendit.

Vazhdojmë me mbledhjen :

R e n d d i t e

1. Arsytimi i mungesave në mbledhje;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
3. Shqyrtimi i raportit financiar për tre mujorin e dytë të vitit fiskal 2023,
4. Njoftimi me raportin e punës së Kryetarit të komunës për 6 mujorë të vitit 2023,
5. Shqyrtimi i raportit të Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2022 dhe miratimi Planit të Veprimit për Eliminimin e të metave të rekomanduara nga AP,
6. Shqyrtimi i Raportit të punës së NPL. "Ambienti" për 6 mujorë të vitit 2023,
7. Shqyrtimi dhe miratimi e Bartjes së mjeteve financiare të pa shpenzuara nga vitet 2022 e me herët.
8. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit – a ka dikush diçka nga anëtarët e kuvendit apo nga ekzekutivi?

Kryetari i Komunës z. Ilir Ferati – përshëndet të gjithë të pranishmit, i uron për punë të mbar, propozon që rendit të ditës ti shtohet edhe një pikë
Shpallja në diskutim publik e Plotësim – Ndryshimit të Rregullores për Transparencë Komunale.

Kryesuesi i Kuvendit – pyet anëtarët e Kuvendit a jeni që kjo pikë të hy në rend dite hedh në votim

Miratohet unanim nga anëtarët e Kuvendit

Konstatojmë që 24 anëtar janë prezent

Hedh në votim rendin e ditës

Miratohet unanim rendi i ditës për këtë mbledhje.

Konstatojmë që 24 anëtar janë prezent

Shqyrtimi i pikës 1.

Kryesuesi i Kuvendit - në mbledhje mungojnë: Agron Gashi për disa arsye personale, ka kërkuar leje dhe Qerim Rexhaj, për arsye shëndetësore.

Shqyrtimi i pikës 2.

Kryesuesi i Kuvendit – Procesverbalin e keni pa a ka dikush ndonjë vërejtje.

Kryesuesi i Kuvendit – pyet nëse ka edhe dikush diçka,
Pasi që nuk keni diçka,
Hedh në miratim
Miratohet unanim pa vërejtje.

Konstatohet që me 24 vota për aq sa janë të pranishëm miratohet procesverbali i mbledhjes së kaluar i datës 31.07.2023.

Shqyrtimi i pikës së 3.

Kryesuesi i Kuvendit- vazhdojmë me piken tjetër, Shqyrtimi i raportit financiar për tre mujorin e dytë të vitit fiskal 2023.

Zyrtari kryesor Financiar, z. Osmon Sadikaj, përshëndet të gjithë të pranishmit, benë prezantimin dhe sqarimin e Raportit financiar për tre mujorin e dytë të vitit fiskal 2023.

Niman Beqiraj-përshëndet të gjithë të pranishmit! Sa i përket tre mujorit të dytë fiskal ndoshta është pak më shqetësuese te kategoria ekonomike, siç ne e quajmë ndryshe investimet kapitale, të cilat janë të një rëndësie të veçantë sepse edhe nevojat e qytetarëve janë të mëdha. Jemi në gjysmën e vitit dhe ritmi i ngadalshëm po shkon vetëm me 9.13% të buxhetit që është shpenzuar nga kjo kategori, dhe çka është me e rëndësishme vetëm 6.59% nga granti qeveritar është shpenzuar deri më tani. Kjo na frikëson sepse me këtë ecuri, mund të kemi prapë suficit të lartë siç kishim edhe vitin e kaluar që te investimet kapitale ishte 28%. Ju kërkojmë të jeni më të vëmendshëm në këtë drejtim, në mënyrë që pastaj mos të bëhen punime të dobëta dhe që nuk i plotësojnë as edhe kriteret minimale për tu quajtur investim. Të gjithë e dimë që nuk shquheni për mirë planifikim dhe nuk keni qenë asnjëherë të saktë në premtime. Mjafton me treguar që punët në qendër keni premtuar që do të përfundojnë në fillim të qershorit edhe para ardhjes së mërgimtarëve dhe ja tani, me vonesa e keni bllokuar të gjithë qytetin. Kërkojmë që të jeni më efikas në këtë drejtim dhe sigurisht edhe më të vëmendshëm. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit Niman! Dikush tjetër a e dëshiron fjalën? Pasi që jo po kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës.

Shqyrtimi i pikës 4.

Kryesuesi i Kuvendit- vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës, 'njoftimi me raportin e punës së kryetarit të komunës për 6 mujorin e vitit 2023. Kryetar, fjala është për ju.

Kryetari i komunës- faleminderit z. Kryesues! Raporti po besoj ka shkuar me kohë, është prezantuar sipas procedurave të rregullores së Kuvendit edhe në dëgjim publik, në bazë të materialit nëse keni pyetje, sugjerime jemi të hapur.

Kryesuesi i Kuvendit- e hapim debatin rreth raportit të kryetarit. Fjalën e ka Niman Beqiraj.

Niman Beqiraj- faleminderit kryesues! Raporti i punës së kryetarit është pothuajse i njëjtë me të vitit të kaluar madje këtë vit është edhe i përshkruar ose me thënë kopje e raportit Janar-Qershor 2022. P.sh në kuadër të zyrës së kryetarit funksionon zyra e integriteteve evropiane, është kopje e periudhës së njëjtë raportuese. Zyra ligjore është me gjetje të përsëritur në raportin e Auditimit. Zyra e personelit nuk ekziston fare, avokati publik mjaftohet me një rresht që thotë 'të gjitha punët i kemi realizuar' auditori i brendshëm përveç që është gjetje e auditorit në raportin e auditorit të përgjithshëm që ka dalë tani, kjo është edhe e njëjtë me pikë e presje me atë të kaluarin. Pra këtu flitet që ende janë në finalizim të raportit të participimit për shërbimet shëndetësore dhe shpenzimet e karburantit në drejtorinë e shëndetësisë 2021-2022. Të gjitha këto që thashë janë në fillim të njoftimit të raportit të kryetarit dhe siç thashë e konstatova që kishte mungesë të seriozitetit qysh në fillim dhe nuk vazhdoja ta analizoj më tutje. Këtë raport të punës e kam lexuar në vitin 2022. Faleminderit!

Kryetari i komunës- Niman, faleminderit për konstatimin, nëse nuk e di unë jam kandidati që i kam fituar zgjedhjet me LDK-në dhe nuk i kam premtuar ndryshimet që i keni premtuar ju. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- dikush tjetër a e dëshiron fjalën? Po konstatoj që jo. Kalojmë në pikën tjetër.

Shqyrtimi i pikës 5.

Kryesuesi i Kuvendit- vazhdojmë me pikën e pestë të rendit të ditës. Shqyrtimi i raportit të Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2022 dhe miratimi i planit të veprimit për eliminimin e të metave të rekomanduara nga Auditori i Përgjithshëm. Fjalën e ka Osman Sadikaj.

Osman Sadikaj- prezanton raportin e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2022.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit shumë Osman! E hapim debatin rreth kësaj pike. Fjalën e ka Niman Beqiraj.

Niman Beqiraj- sa i përket këtij raporti, edhe njëherë ka shfaqur një varg të metave të paaftësisë së qeverisjes lokale, që na pamundëson neve të fitojmë ndonjëherë grantin e përformancës. Si shkelje të gjeturave vlen të përmendet çështja B1 të klasifikimi i

shpenzimeve me të cilën nënkuptojmë që mund të përfshijë manipulim, falsifikim të qëllimshëm, keq përfaqësim ose anashkalim të kontrolleve të brendshme . Sa i përket çështjes B2 vonesa në pagesa të faturave mbi 30 ditë, kishte edhe fatura edhe 264 ditë pa u paguar, kjo vonesë përveç që e dëmton përfituesin, apo operatorët ekonomikë, vështirëson edhe funksionimin e tyre që i presin ato para. Kjo dëmton në të njëjtën kohë edhe buxhetin e komunës me shpenzime të përmblyesit që siç e dimë ato nuk janë të vogla. Sa i përket çështjes B3, sfida në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme për këtë gjetje kemi folur shpesh gjatë vitit në asamble, madje kemi tentuar ta futim si pikë të rendit të ditës, sepse këtu hyn edhe qiratë nga pronat e komunës. Informacioni i përmbledhur për planifikim dhe realizim të buxhetit, pra të kategorisë së investimeve kapitale. Dhe sa i përket çështjes apo gjetjeve të përsëritura, në këtë rast sa i përket planit operativ do votojmë kundër sepse prej vitit 2017, janë duke u përsëritur të njëjtat, ashtu siç e tha edhe ZKF-ja është e njëjtë votove apo nuk votove. Faleminderit!

Osman Sadikaj- e kam vetëm të pjesën e keq klasifikimeve, ju kisha lut të flasim çka thotë raporti i Auditorit, e the një fjalë që të keq klasifikimet ka mundësi të keqpërdorimit, i the do fjalë që nuk i takojnë as Auditorit, unë po jap sqarim, nuk është e vërtetë ajo. Keq klasifikimi ka ndodhur pa dëshirën tonë, i ka marrë thesari mjetet pa na pyet neve.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit Osman! Niman Beqiraj e ka fjalën.

Niman Beqiraj- unë vetëm e tregova se çka nënkupton keq klasifikimi, nuk e thashë që ka ndodhur ajo. Më mirë me thënë është keq planifikim.

Kryesuesi i Kuvendit- mirë Niman! Osman Sadikaj e ka fjalën.

Osman Sadikaj- rregullat ndërkombëtare të kontabilitetit e thonë shumë qartë, çka është keq klasifikim, dhe nuk ka ndodhë. Na kanë marrë prej kapitaleve i kanë dërguar në paga, ky nuk është keq planifikim, ku i gjen thesari të lira i merr. Në këtë rast ka qenë pa fajin tonë. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit Osman! A e dëshiron edhe dikush fjalën. Hajrush Shoshi e ka kërkuar.

Hajrush Shoshi- përshëndet të gjithë të pranishmit! Sa i përket këtij raporti desha ti them disa fjalë, ndoshta janë si lloj reagimi ndaj fjalimeve të mëparshme. Të çështja e keq klasifikimit të mjeteve financiare që janë paguar për shkak të shujtave për mësimdhënës, kjo nuk është çështje e komunës fare. Këto i kemi të bartura nga qeveritë e kaluara, e tanishmja, të gjithë që nuk i kanë pranuar si shpenzim që ka ndodhë. Prandaj, këto janë probleme që ju kanë bartur komunës, është mirë të informohet edhe opinioni publik që nuk është keq menaxhim i komunës, nuk ka të bëjë asgjë me këtë. Sa i përket problemeve tjera që janë paraqitur në raport për mua janë probleme minore. Kaq.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit Hajrush! Fjalën e ka Florin Dreshaj.

Florin Dreshaj- përshëndet të gjithë të pranishmit! Desha ta plotësoj Nimanin me një pyetje. Këto shpenzimet që janë bërë për përmblyesit, a është thirrur dikush në përgjegjësi, sepse këto janë bërë për shkak të vonesës së pagesave. Dhe një pyetje tjetër e

pata, i përmendi Nimani pronat bujqësore më shumë se 84 milionë euro vlerë, që janë pronë e komunës së Istogut, desha ta pyes kryetarin si ka shkuar fushata e korrje fshirjeve. Edhe a po dini se kush po i punon? Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit Florin. Fjalën e ka Osman Sadikaj.

Osman Sadikaj- nuk mund të thirret askush në përgjegjësi për çështjen e këtyre pagesave, te ne në komunë nuk ka përgjegjësi. E tha shumë mirë Hajrush, këtu është marrëveshja e kontratës kolektive të cilën e ka bërë ministria e arsimit dhe e shëndetësisë, në fund të kontratës thotë ‘ që obligohet ministria e arsimit të gjitha shpenzimet që dalin nga kjo kontratë me rastin e qarkores buxhetore t’i alokoj komunave mjete shtesë’. Kurrë nuk ka ndodhë nuk i kanë alokuar. Kanë shkuar e kanë bërë padinë në komunë, për arsye se këta janë punëtorë të komunës, gjykata e ka marrë vendimin pozitiv që komuna ka obligim. E kam thënë shumë herë edhe kur kanë ardhur kërkesat që ne nuk kemi obligim ligjor, thesari thotë mirë ti e ke dhënë mendimin tënd ne ti marrim ku duam. Nuk ka fajtor. Ju faleminderit!

Florin Dreshaj- nuk është e vërtetë ajo që po thoni, më herët keni thënë që nuk do të ketë më vonesë të pagesave, d.m.th ka pas më herët vonesë të pagesave, mos u mundoni të thoni që nuk keni pasur faj, gabimet janë bërë pasojat po i bartë qytetari. Faleminderit!

Osman Sadikaj- një tjetër pozicion i veçantë është, si rekomandim vonesa e pagesave më shumë se 30 ditë, pozicion i veçantë në rekomandim është për keq klasifikim, mos t’i përziejme, çështja e opinionit të Auditimit ka ndikuar konkretisht për rekomandimin nga përmbartuesi, ne po e pranojmë se ka edhe gabime tona, në pagesat më shumë se 30 ditë, po sa është shuma aty, është diku 17 ose 18 mijë euro nuk ka më shumë. Keq klasifikimi është vetëm për pagesat që janë bërë nga përmbartuesi privat. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit Osman! Fjalën e ka kryetari!

Kryetari i komunës- disa çështje janë të kuptueshme, kur diskutojnë njerëz që nuk i kanë informatat e plota, i falim për këtë gabim nga mosdija. E dyta, çështja e keq klasifikimit, është bërë me para planifikim politik prej një auditori të përgjithshëm politik të zgjedhur nga qeverisja që e përfaqësojnë diskutuesit, dhe ju ka ndodhur të gjitha komunave që nuk janë të udhëhequra nga Vetëvendosja. Për tri ditë pa asnjë lloj njoftimi ashtu siç e tha ZKF-ja janë marrë mjetet dhe ligjërisht e kanë keq klasifikuar raportin që të pamundësohet aplikimi ynë në grantin e performancës. Na i kanë marrë 280 mijë euro, përpos saj na i kanë humb edhe 1 milionë të tjera ose më pak varet prej pikësimit, nga granti i performancës edhe me zgjedh pastaj probleme goxha të mëdha të qytetarëve një prej të cilëve ka qenë e planifikuar ka qenë zgjidhja e problemit të kanaleve kulluese që po na shkaktojnë ndryshimet. Mirëpo për shkak të veprimeve politike që me tentuar me e paraqitur këtë që po mundohen ta paraqesin, por qytetari është vigjilent dhe punëve të mira ju thotë puna e mbarë e sidomos qytetari i Istogut. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit kryetar! Florin Dreshaj e ka fjalën.

Florin Dreshaj- nuk më je përgjigj kryetar në pyetjen që e bëra kush i ka punuar tokat bujqësore, është përgjegjësi e jotja, 700 hektarë fshirje korrje, a e di se kush i ka punuar a jo?

Kryetari i komunës-nëse kanë qenë 700 hektarë të mbjella, jam shumë i gëzuar Florin, e sa i përket informacioneve se kush i ka të mbjella, është drejtori i drejtorisë prezent. Për pjesën tjetër të pronave që i kemi qit në thirrje jemi në procedurë e sipër edhe na e vendosim kur i bëjmë thirrjet publike kujt me i dhënë në shfrytëzim pronat komunale jo ju, nëse ke diçka pretendime ose fakte, urdhëro bëj edhe tek ne, çfarë nuk janë për tek ne i ke edhe organet tjera mundesh me i shfrytëzuar lirisht. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit kryetari! Hajrush Shoshi e ka fjalën.

Hajrush Shoshi- unë kërkoj që të respektohet rendi ditës dhe të flitet vetëm për pikën e rendit të ditës të cilën e kemi. Është koha kur bëhen pyetjet nga anëtarët e Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit Hajrush! Florin Dreshaj e ka fjalën.

Florin Dreshaj- pikërisht është rendi ditës kur përmenden në raport të auditimit përmenden, te qiratë përmenden, kështu që nuk jam jashtë rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit- pasi që diskutimi përfundoj, po e hedh në votim, kush është që të miratohet kjo pikë e rendit të ditës?

Konstatoj që 21 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 17 vota për 4 kundër dhe 0 abstenime miratohet pika e rendit të ditës 'Shqyrtimi i raportit të Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2022 dhe miratimi i planit të veprimt për eliminimin e të metave të rekomanduara nga Auditori i Përgjithshëm.

Shqyrtimi i pikës së 6.

Kryesuesi i Kuvendit- vazhdojmë me piken tjetër, Shqyrtimi i Raportit të punës së NPL „Ambienti” për 6 mujorë të vitit 2023,

Menaxheri i NPL „Ambienti” Istog, z. Alferd Tahirsylaj, përshëndet të gjithë të pranishmit, benë prezantimin dhe sqarimin, Shqyrtimi i Raportit të punës së NPL „Ambienti” për 6 mujorë të vitit 2023.

Kryesuesi i Kuvendit- A ka edhe dikush të diskutojë rreth kësaj pike?

Pasi që nuk ka, e hedhim në votim

Konstatohet që nga 21 anëtarë të Kuvendit miratohet unanimit.

Të pranishëm 21 anëtar të Kuvendit të Komunës

Shqyrtimi i pikës së 7.

Kryesuesi i Kuvendit- vazhdojmë me piken tjetër, Shqyrtimi dhe miratimi e Bartjes së mjeteve financiare të pa shpenzuara nga vitet 2022 e me herët.

Zyrtari kryesor Financiar, z. Osmon Sadikaj, benë prezantimin dhe sqarimin e Bartjes së mjeteve financiare të pa shpenzuara nga vitet 2022 e me herët.

Kryesuesi i Kuvendit- A ka edhe dikush të diskutojë rreth kësaj pike? Pasi që nuk ka, e hedhim në votim

Konstatohet që nga 21 anëtarë të Kuvendit miratohet unanim.

Të pranishëm 21 anëtar të Kuvendit të Komunës

Shqyrtimi i pikës 8.

Kryesuesi i Kuvendit - vazhdojmë me piken radhës, Shpallja në Diskutim Publik e Plotësim- Ndryshimit të Rregullores për Transparencë. e hapim debatin rreth kësaj pike? A dëshiron dikush ta marrë fjalën? Atëherë pasi që nuk ka diskutime, e hedh në votim, kush është që të miratohet pika e rendit të ditës,

Hedh në votim

Miratohet unanim

Konstatohet që 21 anëtar të Kuvendit janë prezent në sallë.

Shqyrtimi i pikës 9.

Kryesuesi i Kuvendit – vazhdojmë me piken e fundit Pyetje nga anëtarët e Kuvendit. A ka dikush nga anëtarët e Kuvendit ndonjë pyetje për ekzekutivin.

Niman Beqiraj – kam një kërkesë nga banoret e fshatit Vrellë, që në mini parkun të përmendorja e dëshmoreve që janë komplet të dëmtuara ose të pa shfrytëzuara ulëset aty të zëvendësohen me të reja në mënyra që të shfrytëzohen nga banoret edhe udhëtarët që presin aty.

Pyetja 2 një kërkesë nga banoret e fshatit Banjë të cilët kërkojnë të vendosen vijat e bardha (zebrat) në afërsi të furrës së bukës “Haki Gegolli” në Banjë të Rr. „Bardh Isufi” për tua lehtësuar kalimin këmbësoreve është e nevojshme sepse aty lidhen edhe disa rrugë dhe rrugica tjera të cilat frekuentohen nga qytetaret dhe nxënësit për të shkuar në shkollë, prandaj një investimi vogël për disa vija mendoj që është e lehtë dhe kërkojmë që të shikohen mundësit për realizimin e kësaj kërkesë.

Pyetja 3, stadiumi i futbollit në Istog pra jemi të interesuar me e dit statusin e stadiumit të qytetit me eliminimin që ju behet klubeve, siç e dimë ne ky stadium është i qytetit dhe klubeve të saj që mund ta shfrytëzojnë atë dhe jo të kenë diskriminime një klub ta shfrytëzoj dhe të tjerët jo si rast e kemi shkollën e futbollit të Istogut 03 që është regjistruar në federatë dhe e ka krejt dokumentacioni e nevojshëm madje edhe vendimin e komunës për shfrytëzimin e fushës mirë po nuk i ndahet një orar që mund ta shfrytëzoj atë edhe pas shumë kërkesave pra Istogu 03 për ata që nuk e dinë i ka 360 nxënësi që ndjekin ushtrimet aty nga të cilët 120 janë pa pagës fëmije dëshmoresh, jetim e raste tjera, pjesa tjetër që paguajnë e paguajnë një shumë simbolike, është shkolla e vetme që na ka përfaqësuar edhe në Danimark dhe ka treguar një rezultat të mirë, kërkoj që ti lejohet një orar në stadiumin. Gjate mbledhjes së informatave rreth stadiumit ka qytetar

dhe biznese që ankohen se po diskriminohen edhe ata. Ku shpesh hotelet kontaktohen nga klubet që kur ka ndeshje të qëndrojnë në hotele në Istog, mirë po me pas janë tërhequr sepse nuk ju lejohet shfrytëzimi i fushës për ushtrime nëse nuk vendosesh siç thonë ata në Hotelin e Troftës, pra nuk guxon askush askënd ta ndalojë në shfrytëzimin e pronës komunës që përmes saj të ofroj klientelë e të bëjë konkurrencë klientat të ofrohen me çmime dhe kushte më të mira dhe jo me pronën tonë.

Drejtori i Shërbimeve Publike, z. Abedin Kabashi – përshëndet të gjithë të pranishmit, ne në Vrell mirëmbajtjen e ulëseve jemi duke e bërë. Zebrat në Banjë afër furrës është në kompetencën e Ministrisë ne nuk kemi të drejtë të vendosim asgjë.

Kryetari i Komunës, z. Ilir Ferati – në thashetheme nuk dua të lëshohem. Jo vetëm klubin Istogu03 por secili klub që ka bërë kërkesën vendimin dhe janë të obliguar që për zgjedhjen e orarit me e bërë klubet mes veti në bazë të terminëve që ata i kanë. Nuk janë as dhjetë ditë që kam pasur në zyrë menaxherin e klubit dhe kemi specifikuar këtë çështje, dhe nuk më janë lajmëruar me që kanë pasur ndonjë problem. Me të gjitha klubet kemi një dakordim që stadiumi i qytetit më u shfrytëzuar sa më pak për shkak të dëmtimeve të mundshme për trajnim. Jemi duke punuar edhe për një fushë ndihmesë me bari sintetik sepse bari sintetik nuk dëmtohet sa bari në stadium.

Niman Beqiraj – është e vërtetë se i ke pas në zyrë dhe keni biseduar me ta udhëheqësit e klubit, nuk po e mohoj këtë fakt unë mirë po të njëjtit që unë i kam kontaktuar thonë se nuk na u ka ndarë as një here fusha. Po kërkoj që në bazë të atij vendimi që i keni dhënë t'ia ndani edhe orarin e shfrytëzimit të fushës.

Kryetari i Komunës – kam me i thirr në zyrë prapë edhe taulantin edhe Dardanin nëse ata të kanë thënë që ne nuk i kemi precizuar nuk ju ka hije për më verifikuar më me i thirr në zyrë e më thanë, nëse nuk jam gabim 2 apo 3 ditë pasi që kanë qenë në zyrë të unë ata kanë mbajtur ushtrime në fushën e stadiumit.

Lavdiqe Bujupaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, qytetaret e një kompleksi banesor në qendër të Istogut janë shumë të interesuar me e ditë se çfarë do të ndodhë me statusin e atyre banesave aty në të ardhmen a kanë qasje, a kanë të drejtë që në të ardhmen ato banesa të kthejnë në pronë të tyre përgjithmonë, sipas tyre kanë marrë një fëmijë por kur kanë ardhur këtu gjeja se ende nuk është koha më u privatizuar me kalë në pronë komunale. Kompleksi banesor të sheshi "Ibrahim Rugova",

Kryetari i Komunës z. Ilir Ferati – ne e kemi një komision të themeluar dhe një thirrje publike që është shpallur konform Ligjit për menaxhim të pronave, komisioni po pranon lende çdo ditë, janë lende të ndjeshme asnjëra banës nuk e ka statutin e njëjtë shumica kanë paguar qira AKP-së tash janë në menaxhim të AKP për menaxhim dhe verifikim të pronës.

Qytetaret më pyetje të tilla të orientohen të komisioni dhe zyra ligjore ata jua sqarojnë dhe i udhëzojnë në detaje për këtë çështje.

Hajrush Shoshi – në banjë të furra Gegolli që u përmend të vendosen zebrat a ka ndonjë kërkesë zyrtare ndonjë here prej banorëve të atyshit. Dua ta di nga Nimani se më kënd ka diskutuar për këtë kërkesë?

Drejtori i Shërbimeve Publike, z. Abedin Kabashi – realisht kërkesë zyrtare as private nuk ka sepse nuk është kompetencë e Komunës.

Niman Beqiraj – ne i kemi bërë kërkesë edhe Ministrisë së Linjës për këtë çështje por ne e kemi edhe obligim me ju drejtuar edhe asamblesë.

Haki Podrimaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, aty le të behet një rreth rrotullim sepse ka nevojë e jo vija të bardha, është problem bukur i kahershëm bonja një kërkesë ministrit.

Niman Beqiraj – është një asamblisti se sa dhe mundet me bërë kërkesën vet të ministri e jo më me thanë mu bënë kërkesën se këto punë nuk shkojnë me lidhje të ngushtë, qeveria e Kosovës është e Kosovës dhe nuk ka rendësi a është asamblist apo anëtar i cilës parti je, ne e kemi parë mirë deri sot andaj unë kisha kërkuar nga ti që qatë kërkesën që e ki bërë në kohën kur ka qenë ministër dikush tjetër e që nuk është realizuar bëjeni tash në kohën e LVV dhe shikoje se si ka me të u realizuar.

Faik Alushaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, pompa e vjetër e benzinës a ka mundësi me u hequr nga aty për shkak se është duke u demoluar çdo ditë, është pengës edhe për lëvizje. Ajo vend të behet një park i vogël për pensionera.
Kur kanë me u hequr objektet e vjetra në sheshin “Ibrahim Rugova”.

Kryetari i komunës – sqaron rreth pyetjeve të bëra.

Kryesuesi i Kuvendit – Falënderon për ju të gjithë që patet durimin të qëndroni deri në fund të mbledhjes, dhe dhatë kontributin e juaj,
E shpallë të mbyllur mbledhjen e sotme.
Faleminderit për pjesëmarrje, mirupafshim në mbledhjet e tjera.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 11:35

Procesmbajtëse,
Vjosa Hysenaj



Kryesuesi i mbledhjes,
Enver Rugova

